

# community

The New Apostolic Church around the world

01/2024/AI



## Motoja për 2024: Lutja vepron!

*Kryeartikulli*  
Lutja vepron!

*Shërbesa fetare*  
Ati, fëmijët dhe e gjithë  
familja

*Doktrina kishtare*  
Përzgjedhja dhe thirrja  
në post, në detyrë

New Apostolic Church  
International



## ■ Kryeartikulli

- 3 Lutja vepron!

## ■ Shërbesë fetare

- 4 Ati, fëmijët dhe e gjithë familja

## ■ Këndi i fëmijëve

- 10 Elisea shëron leprozin Naaman
- 12 Për vizitë te Kimberley në Paramaribo (Surinam)

## ■ Doktrina

- 14 Përzgjedhja dhe thirrja për në post, në detyrë

## ■ PJESA RAJONALE

- 18 Mbresa nga një shërbese fetare festive e Apostullit të Distriktit Rainer Storck.
- 19 Dita e të rinjve – një ushqim shpirtëror për ne

# | Lutja vepron!



Foto: Neupostolische Kirche International

Të dashur motra e vëllezër,

pavarësisht nga çfarë ne përjetojmë, ekziston një burim force – edhe pse shpesh nënvlerësohet: Kjo është lutja jonë personale! Ne duhet të jemi të bindur, se lutja jonë dëgjohet dhe se ajo shpesh vepron.

Kjo është edhe motoja jonë për vitin 2024: Lutja vepron!

Shembulli ynë për këtë – si gjithmonë – është Jezu Krishti. Ai pati disa dialoge të përzemërta me Atin. Ai u lut për popullin e tij dhe është ende avokati, ndërmjetësi ynë sot. Lutjet e tij funksionojnë edhe sot. Kjo mund të na japë ngushëllim dhe besim edhe në vitin e ri.

Çfarë bën lutja?

- Lutja të bën mirënjohës.
- Lutja të bën të mëshirshëm.
- Lutja të forcon.
- Lutja të shenjtëron.
- Lutja bashkon.

Në mënyrë që lutja jonë të jetë efektive, ne duhet të lutemi siç na mëson Jezusi.

Nga njëra anë, jeta jonë e lutjes duhet të jetë e qëndrueshme, por edhe serioze. Nga ana tjetër, ne duhet të pyesim në emrin e Jezusit, pra të përqendrohemi te shpëtimi i përjetshëm.

Dhe ne duam gjithashtu të kërkojmë lutjen e përbashkët, në bashkësi, në familje dhe në partneritet.

I uroj të gjithëve një 2024 të bekuar dhe një jetë në lutje të fuqishme.

Të fala të përzemërta



Jean-Luc Schneider

# Ati, fëmijët dhe e gjithë familja



Photos: NAC Canada



Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider vizitoi më  
18 Qershor bashkësinë Halifax (Kanada)

1. Gjoni 3,1

*Shikoni ç'dashuri të madhe na  
dha Ati, që të quhemi bij të Perëndisë.  
Prandaj bota nuk na njeh, sepse nuk  
e ka njohur atë.*

Të dashur vëllezër dhe motra, është vërtet një gëzim i madh të përjetosh këtë shërbesë mes jush sot. Jam i lumtur për bashkësinë që mund të jemi së bashku këtu në kishën tuaj. Ne me siguri do të përjetojmë fuqinë e Frymës së Shenjtë edhe sot. Për sa më përket mua, bashkësia e pranishme është sigurisht pak më e vogël se të dielën e kaluar. Jemi disa mijëra njerëz më pak se në Zambia. Por mos u shqetësoni:

Fuqia e Frymës së Shenjtë nuk varet nga numri i dëgjuesve apo numri i folësve. Fuqia e Frymës së Shenjtë është fuqia e Perëndisë për t'iu drejtuar çdo individ dhe për t'i dhënë atij një mesazh personal. Qofshin dy njerëz apo njëzet mijë njerëz, fuqia e Frymës së Shenjtë është e njëjtë. Ajo do t'i drejtohet çdo individ në situatën e tyre aktuale të jetës, do t'i tregojë se çfarë pret Zoti prej tyre dhe do t'i japë forcë për

ta bërë këtë. Kjo është fuqia e Frymës së Shenjtë. Jam shumë i sigurt se do ta përjetojmë këtë fuqi edhe sot.

Sot kemi një varg biblik të marrë nga letra e parë e Gjonit. Është një letër e veçantë; në fakt është një lloj paralajmërimi për besimtarët e kohës së atëhershme rreth mësuesve të rremë. Bibla nuk shpjegon saktësisht se për çfarë bëhet fjalë. Duket se kishte disa mësues të rremë që nuk besonin në natyrën hyjnore të Jezu Krishtit. Apostujt dhe bashkëpunëtorët e tyre duhej të luftonin kundër këtyre herezive. Nuk e dimë saktësisht se për kë bëhej fjalë, sepse pas një kohe të caktuar këta njerëz thjesht u zhdukën dhe sot nuk e dimë saktësisht se çfarë thoshte mësimi i tyre. Ky është gjithashtu një mësim i mire për ne. Askush nuk e di se për çfarë bëhej fjalë në të vërtetë, porse Ungjilli i vërtetë duroi, i bëri ballë atyre.

Çfarë do të thotë kjo për ne sot shpjegohet shumë thjeshtë: Edhe sot ka shumë njerëz që duan të na shpjegojnë se çfarë thotë Ungjilli dhe si duhet ta kuptojmë atë. Por ne jemi të krishterë apostolikë të rinj dhe besojmë se Zoti i dërgoi apostujt e tij për të shpallur Ungjillin në mënyrën e duhur. Ky është besimi ynë. Kjo është arsyeja pse ne ndjekim shpalljen e apostujve – për t'u përgatitur për kthimin e Krishtit. Nuk duhet ta diskutojmë këtë. Kjo e bën më të lehtë këtë.

Në atë kohë bëhej fjalë për natyrën e Jezu Krishtit. Këta njerëz nuk i pranuan të gjitha mesazhet e Jezu Krishtit dhe një nga mesazhet më të rëndësishme të Jezu Krishtit ishte se ai zbuloi Perëndinë si Atin e tij. Në të kundërt, mund të themi se Perëndia e ka zbuluar veten si Atë nëpërmjet Jezu Krishtit. Populli hebre kishte një kuptim të ndryshëm për Perëndinë. Kur erdhi Jezusi, u tha atyre: Jo, Perëndia është Ati juaj qiellor.

E di që kur e them këtë, marr menjëherë disa reagime: "A do të thotë kjo që Zoti është njeri?"

Jo, Zoti nuk është mashkull, nuk është femër. Ai është shumë më lart se natyra njerëzore. Psalmisti thotë se kujdeset për të tijët, si At ashtu edhe si nënë.

Zoti është Ati i të gjithë njerëzve sepse Ai i krijoi ata dhe Ai ka autoritet mbi Krijimin dhe krijesat e Tij. Ky është mendimi i parë. Ai është Ati sepse Ai është Autori i jetës.

Jezusi gjithashtu iu referua Perëndisë si Ati ynë, sepse të gjithë njerëzit mund t'i flasin atij si një Ati. Jezusi u shpjegoi njerëzve se Perëndia i di nevojat e tyre dhe kujdeset për ta.

Zoti kujdeset për të gjithë njerëzit. Çdo person mund t'i drejtohet atij si Atit të vet. Jezusi tha se Perëndia bën që të bjerë shi për të drejtët dhe të padrejtët dhe bën që dielli të shkëlqejë për të mirët dhe të këqijtë (krh. Mt 5,45). Ai është Ati i të gjithë njerëzve. Kjo është diçka shumë e rëndësishme dhe Jezusi shpjegoi edhe më shumë.

Ai e përshkroi Perëndinë si Atin e dashur që është plot dhembshuri për njeriun mëkatar. Ju e dini historinë: Njeriu u krijua për të jetuar në bashkësi me Zotin. Adami dhe Eva vendosën të largoheshin nga Zoti. Ata u larguan prej tij. Perëndia është Ati i dashur, plot dhembshuri. Ai dëshiron që të gjithë njerëzit të kthehen tek ai. Pali thotë se ai pret të gjithë ata - ata që janë larg dhe ata që janë afër - dhe dëshiron t'i shpëtojë. Ky është Ati.

Zoti është Ati i të gjithë njerëzve. Por ata që nuk besojnë, që - siç thuhet këtu - nuk e kanë njohur, që nuk e kanë pranuar Jezusin, ata që e keqkuptojnë mesazhin e Jezusit, kanë një mendim të ndryshëm për Zotin dhe për njeriun. Për ta, Zoti është gjykatësi që pret Gjykimin e Fundit dhe që do t'i ndëshkojë të gjithë këta mëkatarë të tmerrshëm. Çuditërisht,

shumë të krishterë ende e besojnë këtë. Ata e kanë harruar mesazhin e Jezu Krishtit, i cili e përshkruan Perëndinë si Atin e dashur që dëshiron të shpëtojë të gjithë njerëzit.

Jezusi e përshkroi Perëndinë si Atin e dashur. Shumë të krishterë edhe sot e kësaj dite e trajtojnë Zotin si një lloj idhulli. Ata mendojnë se mund ta blesh Zotin. Ata mendojnë se nëse sakrifikoni mjaftueshëm, nëse bëni gjërat e duhura, atëherë mund të blini hirin dhe bekimet e Tij. "Nëse je i mirë me Zotin, ai do të jetë i mirë me ty, dhe nëse nuk je i mirë me Zotin, ai nuk do të jetë i mirë me ty." Ata e trajtojnë atë si një idhull. Ata bëjnë sakrificat e tyre dhe thonë: "Unë jam i bindur, ndaj ji i mirë me mua!" Kjo nuk është tabloja e Perëndisë, Atit të dashur. Kjo është diçka tjetër.

Të tjerët - përfshirë edhe në rrethin e të krishterëve - e shohin Zotin si mbretin e madh që duhet të sundojë botën dhe të rregullojë problemet e kësaj bote dhe shoqërisë. Disa madje mendojnë se janë thirrur për të ndihmuar Zotin. Ata duan të sundojnë botën të ngarkuar prej tij dhe në emër të tij, si Mbreti i Izraelit në Testamentin e Vjetër.

Jezusi tha: "Jo, mbretëria ime nuk është e kësaj bote. Zoti dëshiron t'ju shpëtojë, t'ju çlirojë nga kjo botë. Por nuk është detyra e Zotit të sundojë botën. Ai nuk ka asnjë interes për këtë."

## Perëndia është Ati i të gjithë njerëzimit

Perëndia është Ati ynë i dashur. Ai i do të gjithë njerëzit, ai dëshiron të shpëtojë të gjithë njerëzit dhe shpëtimi i tij qëndron në jetën e përjetshme.

Ata që nuk besojnë vërtet në Jezu Krishtin ose e kanë keqkuptuar mesazhin e tij gjithashtu mendojnë se Perëndia është shumë përzgjedhës në dashurinë e tij dhe i do disa më shumë se të tjerët - në varësi të prejardhjes, sjelljes, fesë, besimeve të tyre. Kjo definitivisht nuk është e vërtetë! Të gjithë njerëzit janë fëmijë të Perëndisë dhe Ai i do të gjithë me të njëjtën dashuri. Ai dëshiron që të gjithë të jenë me të në përjetësi.

Kjo nuk do të thotë se të gjithë njerëzit përfitojnë nga dashuria e tij. Kjo është diçka tjetër sepse ata duhet të bëjnë diçka për të përfituar nga dashuria e Perëndisë. Por Zoti nuk bën dallim. Ai i do ata të gjithë, mëkatarët si dhe të drejtët. Ai i do ata me të njëjtën dashuri. Ai është Ati dhe njerëzit janë fëmijët e Tij.

Njerëzit ndonjëherë mendojnë se nëse je i pasur do të thotë se Zoti të do dhe të bekon; dhe nëse je i sëmure ose i varfër, ke bërë diçka të gabuar dhe Zoti të refuzon. Edhe kjo është e pakuptimtë! Zoti i do të gjithë fëmijët e tij me të njëjtën dashuri. Edhe nëse nuk sillen mirë, ai nuk do t'i ndëshkojë. Nëse je i varfër, nuk do të thotë se Zoti të refuzon, dhe nëse je i pasur, nuk do të thotë se je i bekuar nga Zoti. Ndonjëherë është pikërisht e kundërta. Por kjo është një histori tjetër.

Ne duhet të kuptojmë se të gjithë njerëzit janë fëmijë të Perëndisë dhe se nuk është vullneti i Tij t'i ndëshkojë

ata ose t'i dënojë mëkatarët. Sepse ndonjëherë njerëzit pretendojnë se kanë marrë një porosi, një detyrë nga Zoti për të ndëshkuar mëkatarët dhe për të dënuar ata që nuk janë ashtu siç duhet të jenë. Ata duan të veprojnë në emër të Zotit për të ndëshkuar dhe dënuar mëkatarët.

Ky definitivisht nuk është vullneti i Zotit! Ai është Ati i të gjithë njerëzve dhe i do të gjithë ata. Ai dëshiron t'i shpëtojë, jo t'i ndëshkojë. Ky imazh i Atit dhe fëmijëve të tij ka kuptim të madh; por ju duhet ta kuptoni këtë në dritën e Jezu Krishtit dhe atëherë do të bëhet e qartë. Ata që nuk e kanë kuptuar mesazhin e Jezu Krishtit, patjetër që kanë një mendim të gabuar për të.

Termi "fëmijë i Perëndisë" ka gjithashtu një dimension shpirtëror: fëmijët e Perëndisë janë ata që kanë lindur përsëri nga uji dhe nga Fryma. Ata janë bërë bashkëtrashëgimtarë me Jezu Krishtin, trashëgimtarë të jetës së përjetshme. Ky është dimension tjetër i të qenurit fëmijë të Perëndisë. Fëmijët e Perëndisë janë ata që kanë marrë të gjitha sakramentet, që besojnë në shpalljen e saktë të Ungjillit dhe që e drejtojnë jetën e tyre drejt kthimit të Krishtit.

Të qenit fëmijë i Perëndisë dhe të trashëgosh jetën e përjetshme nuk është vetëm një çështje e sakramenteve. Jo, të jesh fëmijë i Zotit do të thotë të kesh marrë të gjitha sakramentet, të besosh në shpalljen e saktë të Ungjillit dhe të drejtosh jetën drejt kthimit të Krishtit. Ky është një fëmijë i vërtetë i Perëndisë. Bibla thotë se ata mbajnë emrin e Atit dhe të Birit dhe e mbajnë emrin e Tij të shenjtë me sjelljen e

## *Zoti i do të gjithë bijtë e tij me të njëjtën dashuri*





tyre. Ata praktikojnë drejtësinë dhe bamirësinë. Një fëmijë i vërtetë i Perëndisë i beson Atit të tij pavarësisht se çfarë i ndodh. Pali tha: "Abba, Ati dashur". Me këtë ai donte të shprehte: "O Zot, ti je Ati im, të besoj!" Kjo do të thotë të jesh me të vërtetë bir i Zotit!

Një fëmijë i tillë i Zotit jeton në liri. Çfare do të thotë kjo? Bibla thotë se ata që udhëhiqen nga Fryma e Shenjtë janë vërtetë fëmijë të Perëndisë. Ata janë të lirë. Kjo liri e bijve të Zotit – unë ngul këmbë në këtë pikë - do të thotë se ata nuk janë të shtyrë nga natyra e tyre njerëzore. Sjellja e tyre nuk diktohet nga nevojat e tyre. Sjellja e tyre nuk diktohet nga situata në të cilën jetojnë, pasuria apo varfëria e tyre. Sjellja e tyre, opinionet e tyre, nuk diktohen nga mediat kryesore dhe sociale. Një fëmijë i Perëndisë thotë: "Njerëzit mund të thonë çfarë të duan. Ata mund të bëjnë çfarë të duan. Situata mund të jetë kjo që është. Këto gjëra nuk do të përcaktojnë se si unë duhet të sillem."

Një fëmijë i Perëndisë udhëhiqet nga Fryma e Shenjtë; çfarë bën, çfarë mendon dhe çfarë thotë përcaktohet nga besimi i tij, i cili është aktiv në dashuri. Kjo është liria e fëmijëve të Perëndisë. Sjellja e tyre, ndjenjat e tyre përcaktohen vetëm nga një gjë, nga besimi i tyre, që i bën të kuptojnë: "Unë jam një fëmijë i Zotit. Zoti është Ati im. Ai më do mua. Ai dëshiron të ketë shoqëri të përjetshme me mua në

mbretërinë e tij. Atje dua të jem edhe unë." Kjo është liria e fëmijëve të Zotit.

Përsëri, njeriu duhet të kuptojë mesazhin e Jezu Krishtit për të kuptuar se çfarë do të thotë të jesh fëmijë i Perëndisë. Sepse vjen i ligu - është gjithmonë e njëjta strategji - dhe thotë para së gjithash: "Nëse je fëmijë i Perëndisë, atëherë..." Siç i tha Jezu Krishtit: "Nëse je Biri i dashur i Perëndisë, atëherë nuk duhet të vuash". Ai na shtyn të dyshojmë në të qenurit bir i Perëndisë duke thënë: "Si mund të pretendosh të jesh fëmijë i Perëndisë? Ai supozohet të të dojë, të jetë Ati yt dhe ti duhet të kalosh një situatë kaq të vështirë? Shikoni të tjerët! Ata kanë më shumë para, ata janë të shëndetshëm dhe ju jeni të sëmurë. Ata janë të lumtur dhe ju keni shumë probleme", e kështu me radhë. Ju e njihni këtë shpirt, këtë frymë të ligë.

Por kushdo që e njeh Jezu Krishtin, e di se Jezu Krishti ishte Biri i Perëndisë dhe se Perëndia e dëshoi; por megjithatë ai duhej të vuante dhe u persekutua. Të jesh një fëmijë i dashur i Zotit nuk do të thotë që njeriu të kursehet nga çdo vuajtje. Njëra nuk ka lidhje me tjetrën. Të jesh fëmijë i Perëndisë do të thotë të kesh mundësinë për të hyrë në Mbretërinë e Perëndisë dhe për të trashëguar jetën e përjetshme. Ky është kuptimi. Nuk ka të bëjë fare me të qenit i sigurt nga të gjitha vuajtjet dhe i bekuar në të gjitha gjërat tokësore.



Kushdo që e njeh Jezu Krishtin e di se çfarë do të thotë të jesh fëmijë i Perëndisë. Ai shikon Jezusin dhe çfarë i ndodhi atij dhe e di: "Mirë, është normale që do më ndodhë edhe mua."

Një fëmijë i vërtetë i Perëndisë e di gjithashtu se nuk ka asgjë më të rëndësishme në jetën e tij sesa të qenit fëmijë i Perëndisë. I ligu, armiku i Jezu Krishtit, dëshiron ta shkatërrojë atë. Ai do që ne të mendojmë se jeta jonë tokësore është shumë më e rëndësishme se birësimi ynë ndaj Perëndisë; ai dëshiron që mendimet dhe pikëpamjet tona të jenë më të rëndësishme për ne; pasi disa gjëra në jetën tokësore na përkasin thjesht neve.

Por një fëmijë i Perëndisë e di: "Jo, fakti që jam fëmijë i Zotit është më i rëndësishëm se jeta ime tokësore. Nuk ka të bëjë me mua, me idetë e mia, opinionet e mia, të drejtat e mia. Unë kam të drejtën të hyj në mbretërinë e Perëndisë si fryti i parë; Unë dua të transformohem në imazhin e Jezu Krishtit dhe kjo është gjëja më e rëndësishme për mua. Të qenit fëmijë i Zotit është më e rëndësishme për mua sesa të përmbush vetveten." A e kuptoni se çfarë dua të them? Të qenurit fëmijë i Zoti është më e rëndësishme se ekzistenca jonë tokësore. Jezu Krishti na dha shembullin. Për të, të qenit Biri i Perëndisë, i dërguar nga Perëndia, do të thoshte shumë më tepër sesa të qenit Jezusi i Nazaretit. E njëjta gjë vlen edhe për ne.

Perëndia dëshiron t'i mbledhë fëmijët e tij për t'i udhëhequr në mbretërinë e tij. Ai dëshiron që fëmijët e tij të jenë një dhe të kapërcejnë dallimet e tyre. Vendi ku ata mund të kapërcejnë dallimet e tyre është kisha. Ky është vullneti

i Perëndisë, vullneti i Jezu Krishtit. "Po, të gjithë jeni krejtësisht të ndryshëm, por unë dua që ju të bëheni një dhe vendi ku mund të kapërceni dallimet tuaja është kisha."

Këtu kemi një problem në shoqërinë e sotme, sepse në shoqërinë e sotme njerëzit prirën të këmbëngulin në dallimet e tyre. Të gjithë duan të përcaktojnë veten përmes ndryshimeve të tyre: "Unë jam ndryshe, i përkas këtij apo atij grupi, kështu jam dhe ju duhet të më pranoni në këtë ndryshim; dhe për shkak se jam ndryshe, kam këtë dhe atë të drejtë", e kështu me radhë. Unë thjesht pyes veten: si planifikoni të ndërtoni një shoqëri mbi një ndarje të tillë? A nuk e kuptoni se qëllimi i vetëm i kësaj fryme është të përçajë gjithnjë e më shumë? Nuk është çudi që është pothuajse e pamundur të krijohet unitet në këtë shoqëri. Nuk është çudi që kjo shoqëri të ndahet gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më pak mbështesin njëri-tjetrin. A nuk do të ishte më mirë që njerëzit të përqendroheshin në atë që kanë të përbashkët dhe jo në atë që i bën ata të ndryshëm?

Si apostull kryesor – falë Zotit – nuk jam përgjegjës për shoqërinë. Por vëllezër e motra, le të shqyrtojmë këtë: Cila është fryma që qëndron pas gjithë këtyre gjërave? Fryma e ndarjes. Sa më shumë grupe të ketë - secili aq i rëndësishëm dhe kaq i ndryshëm - aq më e ndarë do të jetë shoqëria dhe aq më shumë egoizëm do të ketë në botë.

Le të kthehemi te kisha: Ajo që është e rëndësishme për ne nuk janë dallimet tona, mendimet e opinionet tona. Zoti dëshiron që ne të jemi një. Pali tha se në Krishtin nuk ka grekë dhe hebrenj. Nuk e kemi idenë se çfarë do të thoshte kjo për shoqërinë e asaj kohe. Për ne ka vetëm dy fjalë:





Apostuli Jonathan Karl Sturm

"grekë" dhe "hebrenj". Kjo do të thoshte shumë për njerëzit në atë kohë. Nëse futesh pak më thellë në këtë temë, do të kuptosh se në të vërtetë kishte dy botë, jashtëzakonisht të ndryshme. Dhe Pali thotë: Këtu nuk ka as hebre as grek, këtu nuk ka as skllav as të lirë, këtu nuk ka as mashkull as femër; sepse të gjithë jeni një në Krishtin Jezus."

Kjo do të thoshte shumë në këtë shoqëri. Ju nuk mund ta imagjinoni se çfarë fshihej pas këtyre fjalëve për njerëzit në atë kohë. Për ne është thjesht një figurë fjalësh, por ju lutemi hidhni një vështrim më të afërt në kontekstin historik dhe social të asaj që do të thoshte në këtë kohë të jesh grek apo çifut, të jesh njeri i lirë apo të jesh skllav.

Dhe Pali thotë se nuk ka më dallime në kishë, në Krishtin. Ajo që kemi të përbashkët është shumë më e rëndësishme se ajo që na ndan. Të gjithë duhet të lëmë mënjanë mendimet tona dhe të shndërrohemi në imazhin e Krishtit. Thirrja që na është bërë ne është më e rëndësishme se të drejtat tona. Misioni ynë është më i rëndësishëm se çdo avantazh që mund të kemi, e kështu me radhë.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ne jemi fëmijë të Perëndisë. Zoti dëshiron që familja e tij, fëmijët e tij, të jenë një. Vendi ku ata mund të kapërcejnë dallimet e tyre është kisha, dhe me ndihmën e Frymës së Shenjtë ne mund ta bëjmë këtë dhe të jemi vërtet një në Jezu Krishtin - dhe ky është qëllimi ynë.

Mesazhi është i qartë: Perëndia është Ati ynë i dashur, Ai kujdeset për ne. Mos u shqetësoni, ai i di mirë nevojat tuaja dhe do të kujdeset për ju. Ju lutemi pranoni që edhe fqinji



Apostuli i distriktit Rüdiger Krause

juaj është fëmijë i Perëndisë dhe se Zoti e do atë po aq sa ju do ju; dhe pranoni se nuk ka absolutisht asnjë ndryshim. Askush nuk mund ta sundojë botën në emër të Zotit. Askush nuk mund të luftojë mëkatarët dhe t'i dënojë ata në emër të Zotit. Zoti është Ati i dashur i të gjithë njerëzve.

Ne jemi fëmijë të Perëndisë sepse kemi marrë të gjitha sakramentet. Ne besojmë në shpalljen e saktë të Ungjillit. Ne duam ta lidhim jetën tonë me kthimin e Jezu Krishtit. Po, ne mbajmë emrin e Atit dhe të Birit dhe bëjmë gjithçka që mundemi për ta mbajtur atë të shenjtë duke praktikuar drejtësi dhe dashuri. Ne jemi fëmijë të Perëndisë dhe duam të jemi një në Krishtin. Me ndihmën e tij ne mund të kapërcejmë të gjitha dallimet.

## MENDIME KYÇE

Zoti është Ati i të gjithë njerëzve, ai i do të gjithë me të njëjtën dashuri dhe dëshiron t'i shpëtojë. Besimtarët e rilindur nga uji dhe Shpirti, të cilët përqendrojnë jetën e tyre në kthimin e Krishtit, do të trashëgojnë jetën e përjetshme. Ne i japim përparësi birësimit tonë si fëmijë të Perëndisë dhe unitetit të kishës.

## ELISEU SHËRON LEPROZIN NAAMAN

### SIPAS 2. MBRETËRVE 5

*Naamani ishte një kapiten arameish. Mbreti i tij e vlerësonte shumë, sepse nëpërmjet tij arameat (sirët) mundën Izraelin. Ai është një burrë i fuqishëm, por ishte leproz.*

Gruaja e Naamanit kishte një shërbëtore. Kjo familje luftëtarësh e kishin marrë vajzën e re me vete që nga Izraeli. Ajo i tha zonjës së saj: „Ah, sikur të mund të shkonte zotnia im tek Profeti në Samari! Ai mund ta shëronte atë nga leproza.“

Naamani i thotë mbretit, atë që dëgjoj nga shërbëtorja e tij. Atëhere mbreti nga Arami i shkruan një letër mbretit të Izraelit, me qëllim që të ndihmohej Naamani.

Naamani merr dhjetë talenta argjendi dhe gjashtë mijë guldena ari dhe dhjetë rroba dhe ia çon letrën mbretit të Izraelit. Në letër shkruhej: „

Kur të të vijë kjo letër, dije se të kam dërguar shërbëtorin tim Naaman për ta shëruar nga lepra e tij.“ Kur mbreti i Izraelit lexon letrën, grisi rrobat e tij dhe thotë: „A jam unë Perëndi që mund të marr dhe të jap jetën?“

Si mund ta çliroj unë njeriun nga leproza e tij? Vini re dhe shikoni se si mbreti i Aramit kërkon grindje me mua!”

Profeti Elise e dëgjon këtë. Ai i dërgon një lajmëtar mbretit dhe i thotë: „Lëreni Naamanin të vijë tek unë, që të dijë se ka një profet në Izrael.“ Naamani vjen me kuaj dhe karroca dhe ndalon te dera e shtëpisë së Eliseut.

Eliseu i dërgoi një lajmëtar dhe i tha: „Shko dhe lahu shtatë herë në Jordan dhe lëkura jote do të shërohet dhe do të jesh i pastër.“

Atëherë Naamani zemërohet dhe thotë: „Unë mendoj se ai vetë duhet të vijë tek unë dhe të thërrasë emrin e Zotit, Perëndisë të tij, të ngrejë dorën drejt shenjtërores dhe kështu të më çlirojë nga lepra. A nuk janë lumenjtë e Damaskut, të Abanas dhe të Parparit më të mirë se të gjitha ujërat e Izraelit? A nuk mund të lahesha në to dhe të



bëhesha i pastër?“ Ai largohet dhe kthehet i zemëruar. Shërbëtorja e tij vjen tek ai dhe i thotë: “I dashur baba, nëse Profeti do të kishte urdhëruar të bëje diçka të madhe, a nuk do ta kishe bërë atë? Aq më tepër kur ai të thotë: Lahu dhe do të behesh i pastër!”.

Naamani e dëgjon shërbëtoren e tij. Ai zbret nga qerrja dhe zhytet shtatë herë në Jordan, siç e urdhëroi profeti. Dhe mishi i tij u bë përsëri i shëndoshë, si mishi i një djali të ri, dhe ai u bë i pastër.

Ai kthehet te Eliseu me gjithë njerëzit e tij. Naamani i del përpara dhe i thotë: „Ja, tani e di se nuk ka Perëndi përveç Perëndisë të Izraelit. Më lër të të jap diçka dhe të të bekoj.”

Eliseu nuk pranon asgjë prej tij, por i thotë: „Shko në paqe!”

Kur Naamani tashmë është larguar pak, Gehazi, shërbëtori i Eliseut, thotë me vete: „Do të vrapoj pas tij dhe do ta lë të më japë diçka.“ Gehazi ndjek Naamanin. Naamani kur sheh Gehazin, zbret nga qerrja, shkon ta takojë dhe i thotë: “A je mirë?” Shërbëtori i thotë:

“Po. Por Zoti im më ka dërguar që t’ju them diçka. Dy nga dishepujt e profetëve nga mali i Efraimit erdhën tek ai. Jepu atyre njëqind peshë argjendi dhe dy veshje ceremoniale!”

Naamani madje i jep Gehazit dy talenta argjendi dhe dy rroba; Shërbëtorët e Naamanit i çojnë dhuratat në shtëpi për Gehazin. Pastaj ai vjen përpara Eliseut. Ky e pyet: “Nga vjen?” Gehazi i shmanget. Por Eliseu e di saktësisht se çfarë ka ndodhur: «Ti ke marrë argjendin dhe rrobat dhe do të pajisesh me kopshte ullinjsh, vreshta, dele, bagëti, shërbëtore dhe gra. Por leproza e Naamanit do të bjerë mbi ty. Edhe pasardhësit e tu do të kenë leprozë.» Pastaj Gehazi largohet. Ai u mbush me leprozë të bardhë si bora.



## PËR VIZITË TEK KIMBERLEY NË PARAMARIBO (SURINAM)



A keni dëgjuar ndonjëherë për Surinam? Atdheu im është vendi më i vogël në Amerikën e Jugut. Në përdim kufizohet me Guajanën dhe në lindje me Guajanën Franceze, e cila i përket Francës dhe për këtë arsye është pjesë e Bashkimit Evropian. Rreth 590,000 njerëz jetojnë në Surinam, shumica prej tyre, si familja ime dhe unë, në kryeqytetin Paramaribo. Meqë ra fjala, quhem Kimberley dhe jam dhjetë vjeçe.

Surinam ka qenë më parë një koloni e Hollandës, derisa u bë Republikë e pavarur më 25 Nëntor 1975. Prandaj ne flasim krahas gjuhës së nënës Sranan Tongo edhe hollandisht, e cila është edhe gjuha zyrtare në shkolla.

Shoqet e mia quhen Cherencia dhe Noranja. Jemi në të njëjtën klasë.

Më pëlqen të mësoj gjuhë të huaja. Unë flas hollandisht, Sranan Tongo, spanjisht dhe pak anglisht. Në foton e klasës do më gjeni të dytën nga e majta në rreshtin e parë.



Këtu kam dalë me prindërit e mi. Babai im Harvey është drejtues distrikti për Surinam dhe shef i një firme ndërtimi. Ai kujdeset për riparimet në kishat tona dhe nganjëherë ndërton edhe kishë të re. Tani ai po ndërton një stacion mjekësor pranë kishës sonë në Dankbaarkondre.

Nëna ime Eveliza ka lindur në Republikën Domenikane. Atje flasin spanjisht, gjuhë që ma mëson edhe mua. Ajo drejton dyqanin e fondacionit të kishës Corantijn në Welbedacht. Dyqani quhet Makandra, që në gjermanisht do të thotë Sëbashku. Direkt pranë tij ndodhet kisha jonë, ku unë me vëllezërit e mi Angel dhe Raul si dhe me nënën time shkojmë në shërbesa fetare.



Distrikti i Surinamit përfshin dhjetë bashkësi me rreth 700 vëllezër dhe motra. Këtu mund të shihni bashkësinë tonë.

Ushqimi që pëlqej më shumë është dominikane e quhet Nasi, gjellë me oriz, por here pas here më pëlqen edhe Burger.



Hobbet e mia janë të eci me biçikletë dhe të luaj, si dhe e dua muzikën. Por luaj me kënaqësi edhe me macen time.





Photos: NAC Canada

## Përzgjedhja dhe emërimi në detyrë

Eshtë sqaruar tashmë “çfarë” dhe “kush” përsa i përket Të kuptuarit e postit apo detyrës. Ende lind pyetja: Pse i shërben posti besimtarit? Apostulli kryesor Jean-Luc Schneider e shpjegon këtë në këtë shkrim mësimor.

Artikulli i pestë i besimit apostolik të ri thotë: "Unë besoj se ata që zgjidhen nga Zoti për një detyrë emërohen vetëm nga apostujt." Katekizmi specifikon:

- Posti, detyra nuk është as punë e njeriut dhe as e bashkësisë – ajo është një dhunti që Perëndia ia jep kishës së tij.
- Është vetë Zoti që zgjedh një person për t'ia besuar atij një detyrë.
- Kjo zgjedhje realizohet nga Zoti me rastin e një emërimi të kryer nga apostulati (KNK 2.4.5).

## Të ruash dhe forcosh besimin

Besimi në zgjedhjen dhe thirrjen hyjnore në poste apo në detyrë është pjesë e pasurisë së Kishës sonë. Ai është burim motivimi dhe force për motrat dhe vëll. e admin. Në të njëjtën kohë, kontribuon në pranimin e postit, detyrës shpirtërore nga ana e bashkësisë.

Ne themi se është Zoti ai që e zgjedh njeriun përpara emërimit dhe se kjo përzgjedhje gjen shprehje në vendimin e apostullit për ta emëruar atë. Megjithatë, duhet pranuar se ky shpjegim është disi shumë i shkurtër duke pasur parasysh rëndësinë e temës.

Disa rrethana të caktuara mund të bëjnë që dikush të vërë në dyshim caktimin hyjnor të një motre apo vëllai admin. Ky është rasti, për shembull, kur rezultojnë se një motër apo vëll. admin. nuk është në lartësinë e duhur në punën e tij ose kur ai dështon në zbatimin e detyrës së tij.

Në shumicën e rasteve, zgjedhja e motrave dhe vëllezërve që do të emërohen bëhet si më poshtë:

- Ata që janë përgjegjës në vend i paraqesin apostullit një listë të atyre që rekomandohen për emërim.
- Mbi bazën e këtyre sugjerimeve, apostulli (ose apostulli i distriktit) zgjedh personat që do të emërohen.
- Një përfaqësues lokal kontakton njerëzit e përzgjedhur dhe u shpjegon atyre se çfarë pritet prej tyre.
- Nëse personat japin pëlqimin e tyre, apostulli i emëron ata në detyrë.

Nuk është domosdoshmërisht e vetëkuptueshme që të pajtohet kjo qasje, kjo mënyrë "administrative" me përcaktimin hyjnor. Prandaj, mendoj se do të ishte e dobishme të shpjegohesh pak rreth koncepteve të zgjedhjes hyjnore dhe emërimit në detyrë.

## Përzgjedhja hyjnore

Ashtu si të gjitha vendimet që merr Perëndia, emërimi hyjnor në detyrë është një mister që mund të kuptohet vetëm me anë të besimit. Asnjë apostull nuk mund të

pretendojë se e kupton plotësisht pse Zoti zgjedh një besimtar për t'ia besuar atij një detyrë të veçantë. Detyra e apostujve është thjeshtë të njohin vullnetin e Zotit dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat (KNK 7.7).

Për të përcaktuar se cilët besimtarë thirren nga Perëndia për në post apo detyrë, duhet marrë parasysh sa vijon:

Nevojat e Kishës: Posti, detyra nuk është qëllim në vetvete, ai është dhënë nga Zoti për të plotësuar nevojat e Kishës së Tij. Apostulli dhe bashkëpunëtorët e tij duhet të udhëhiqen nga Fryma e Shenjtë për të dalluar nevojat dhe pritshmëritë e kishës.

Dhuntitë shpirtërore: Me qëllim që personit që Ai ka zgjedhur t'ia besojë një post, Perëndia i jep dhuntitë shpirtërore të nevojshme për ushtrimin e tij. Një besimtar që është thirrur në një post apo detyrë e dallojmë nga

- besimi i tij në Jezu Krishtin, në vdekjen, ringjalljen dhe rikthimin e tij.
- besnikëria e tij ndaj Ungjillit.
- besimi i tij në kishën si ndërmjetëse e shpëtimit, te apostujt, te sakramentet dhe tek posti, detyra.
- dashuria e tij për Zotin dhe për besimtarët.
- gatishmëria e tij për të shërbyer.

Aftësitë njerëzore: Zgjedhja e Zotit reflektohet edhe në aftësitë që i ka dhënë besimtarit. Për t'u përfshirë janë p.sh. aftësia për të dëgjuar, aftësia për të dialoguar, aftësia për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme, nga aftësia për të pasë mendje të hapur, sens të përbashkët, njohuri ose aftësi dhe vullnet për të mësuar. Apostulli dhe bashkëpunëtorët e tij duhet të sigurohen që aftësitë njerëzore të motrës apo vëllait te admin - d.m.th. karakteri emocional ose intelektual - të përmbushë nevojat e bashkësisë në të cilin ai është emëruar të shërbejë.

Pranimi nga bashkësia: Shërbimi është një dhuratë që Zoti i jep bashkësisë. Ai zgjedh një motër dhe vëlla admin nga mesi i besimtarëve që duhet t'u shërbejë atyre. Apostulli duhet të sigurohet që besimtari që ai dëshiron të emërojë do të pranohet nga bashkësia. Në kishën e hershme, apostujt i kërkuan bashkësisë të zgjidhte shtatë burra që do të emëroheshin si diakonë (Veprat e Apostujve 6,1-6). Në ditët tona, ky vendim i takon bashkësisë lokale apo drejtuesve të rretheve që veprojnë në emër dhe për llogari të bashkësisë. Duke i paraqitur propozimin e tyre apostullit, vëll. drejtues të admin. konfirmojnë se bashkësia ka njohur (ose mund të jetë në gjendje t'ia njohë) dhuntitë dhe aftësitë shpirtërore të atyre besimtarëve, emërimin e të cilëve ata dëshirojnë.

Pranimi i emërimit të tij nga besimtari: Përzgjedhja hyjnore shkon gjithmonë paralelisht me thirrjen që

Zoti bën. Zoti thërret personin që ka zgjedhur dhe i jep mundësinë të vendosë nëse do ta pranojë apo jo zgjedhjen e tij. Ne besojmë se kjo thirrje i bëhet besimtarit nëpërmjet apostullit ose, nëse është e nevojshme, përfaqësuesit të tij. Por kjo sigurisht nuk është e vetmja mënyrë që Perëndia mund ta thërrasë një besimtar në shërbimin e Tij.

Thirrja hyjnore shprehet edhe në zhvillimin personal të personit të thirrur. Nëpërmjet rrethanave të jetës dhe përvojave personale, Zoti zgjon në zemrën e tij

- mirënjohje për dhuntitë dhe mirësitë e dhuruara.
- dashurinë për Zotin dhe kishën.
- dëshirën e sinqertë, të lindur nga kjo mirënjohje dhe kjo dashuri, për t'i shërbyer Zotit dhe Kishës.

## Të konsolidosh zgjedhjen dhe thirrjen

Është ndërthurja e ndjenjës së thirrjes së brendshme me thirrjen e apostullit që i mundëson besimtarit të arrijë sigurinë se është thirrur nga Zoti në një post, detyrë. Personi i thirrur duhet të konfirmojë zgjedhjen dhe thirrjen e tij (2 Pjetrit 1,10) duke deklaruar vullnetarisht

- se është dakord me artikujt e besimit apostolik të ri.
- se është dakord të kryejë detyrën brenda mandatit që i është dhënë.
- se është dakord për të punuar në unitet me apostolatin dhe postet e tjera.
- se është dakord t'u përmbahen rregullave dhe rregullores së Kishës Apostolike të Re.

Është e rëndësishme që personi i thirrur të vendosë lirisht dhe me vetëdije të plotë për rëndësinë e çështjes. Ai duhet të dijë se për çfarë po angazhohet dhe çfarë pasojash rrjedhin nga ky angazhim. Për këtë arsye është e rëndësishme përfshirja e bashkëshortes/it në procesin e vendimmarrjes.

Pas emërimit, motra apo vëll i admin duhet të forcojë më tej emërimin e tij ose të saj duke:

- shenjtëruar veten.
- u përpjekë të njohë vullnetin hyjnor dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat.
- thelluar unitetin me apostolatin dhe postet e tjera.
- zhvilluar dhuntitë dhe aftësitë e tij /saj.
- ndërmarrë trajnime të mëtejshme për të fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e tij/saj.

Udhëheqja e kishës, nga ana tjetër, duhet të sigurojë që motra apo vëll i admin të udhëzohet në postin e tij dhe të mbështetet në punën e tij. Bashkësia duhet ta mbështesë motrën apo vëllin e admin me lutjet e saj, por edhe të tregojë vlerësimin dhe solidaritetin me të.

## Nuk ka garanci për sukses

Zgjedhja e Zotit, e cila realizohet nëpërmjet emërimit, nuk përjashton mundësinë që një motër apo vëlla admin të dështojë në ushtrimin e detyrës së saj/tij. “Megjithatë, kjo nuk e vë në dyshim thirrjen origjinale të Zotit” (KNK 2.4.5).

Katekizmi këtu bën një dallim midis Zotit, i cili është i përsosur dhe i pagabueshëm, dhe njeriut, i cili, megjithëse i zgjedhur, mbetet i papërsosur dhe i gabueshëm.

Për të shmangur çdo keqkuptim, ne e bëjmë të qartë që në fillim se çfarë nënkuptojmë me dështim në kryerjen e detyrave tona. Dështimi për të cilin po flasim këtu nuk i referohet “rezultateve” të arritura, por mënyrës sesi motra apo vëll i admin përmbush vullnetin hyjnor.

Arsyet që mund të pengojnë një motër apo vëll admin të përmbushë detyrat e saj/tij zyrtare mund të jenë të natyrave të ndryshme:

- Dështimi që i atribuohet një motre apo vëll admin: Një motër apo vëlla admin nuk mund të jetë i suksesshëm në ushtrimin e detyrës së tij nëse ajo/ai
  - sillet në mënyrë të papajtueshme me detyrën e tij.
  - nuk lidhet me apostolatin.
  - bën që ai të humbasë besimin e bashkëbesimtarëve të tij nëpërmjet qëndrimit të tij
  - refuzon të vendosë dhuntitë dhe forcën e tij në shërbim të kishës.

Në të gjitha këto raste, motra apo vëll i admin e privon veten nga bekimi hyjnor dhe për këtë arsye veprimet e tij janë të dënuara me dështim. Megjithatë, veprimet që ai ka kryer brenda fushës së autoritetit të tij zyrtar (dhënia e sakramenteve, shpallja e faljes së mëkateve, dhënia e bekimeve, shpallja e fjalëve të duhura) nuk vihen në dyshim nga sjellja e tij. Ato mbeten të vlefshme dhe mund të shpалosin të gjitha efektet e tyre.

Dështimi që i atribuohet bashkësisë: Dobësia njerëzore mund të çojë në intolerancën e anëtarëve të bashkësisë apo edhe në një qëndrim armiqësor ndaj një motre apo vëll admin. Nga ky moment ai nuk mund të përmbushë më misionin e tij për ta. Por ky dështim më pas duhet t'i atribuohet bashkësisë dhe jo motrës apo vëllin të admin.

Çfarë i atribuohet udhëheqjes së kishës: Apostujt janë gjithashtu njerëz të papërsosur që mund të bëjnë gabime. Kur duket se një vëll admin, pavarësisht nga përpjekjet e tij më të mira, nuk po e përmbush detyrën e tij, apostulli duhet të ketë ndershmërinë për të vënë në dyshim





vendimin e tij. Ndoshta janë bërë gabime në vlerësimin e nevojave të bashkësisë apo aftësive të motrës apo vëll të admin. Megjithatë, apostulli është i detyruar ta ndihmojë këtë shërbëtor, ta përshtatë detyrën e tij me aftësitë e tij nëse është e nevojshme dhe të sigurojë që ai dhe, familja e tij të marrin kujdesin e duhur shpirtëror kurdo që është e nevojshme.

Dështimi për shkak të rrethanave të jashtme: Në disa raste, pas emërimit të personit të thirrur, ndodhin ngjarje që e bëjnë të vështirë ose edhe të pamundur ushtrimin e detyrës së tij. Ky është rasti, për shembull, nëse

- motra apo vëll i admin përjeton probleme shëndetësore ose ndryshime të rëndësishme në jetën e tij familjare ose profesionale.
- përbërja e bashkësisë ka ndryshuar aq ndjeshëm sa që kjo çon në kërkesa të reja.
- zhvillimet demografike po e detyrojnë kishën të ndryshojë organizimin e saj.

Ndryshime të tilla nuk e vënë në dyshim thirrjen e Zotit, por më tepër na bëjnë të marrim parasysh

- atë që Zoti pret tani.
- çfarë duhet bërë që vëll i admin të ushtrojë autoritetin e tij zyrtar sipas vullnetit të Zotit.
- nëse mandati zyrtar i vëll të admin duhet të rregullohet.
- nëse ka ardhur koha që vëll i admin të lirohet nga detyrat e tij zyrtare.

Ushtrimi i detyrës nuk është garanci për shpëtimin shpirtëror dhe fakti i dështimit në detyrë nuk e përjashton vëll e admin nga aksesimi për shpëtim. Detyra jonë ndaj tij mbetet e pandryshuar: ta ndihmojmë të arrijë shpëtimin e tij. Nuk është detyra e apostujve të gjykojnë ata që refuzojnë detyrën. Së fundi, nuk duhet harruar se zyrtarët që hasin vështirësi në kryerjen e detyrave të tyre kërkojnë ngushëllim dhe mbështetje të veçantë.

Masthead

Publikuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zürich/Switzerland

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Simon Heiniger

## Mbresa nga një shërbese fetare festive e Apostullit të Distriktit Rainer Storck.

Ishte ditë e dielë, 10 shtator 2023. Dita ishte me diell dhe bënte pak vapë. Temperaturat ishin jo si në ditët e mëparshme. Por gjithsesi djersa të dilte çurk. Dhe kryeplaku ynë Andrea Rafaeli më kishte caktuar të shkoja në bashkësinë e Elbasanit, një bashkësi shumë simpatike dhe shumë besimtare, motrat dhe vëllezërit e të cilës na kanë mirëpritur dhe na mirëpresin jashtëzakonisht mirë. Janë motra dhe vëllezër, që të shikojnë dhe shohin drejt e në sy, kur ne, vëllezërit, mbajmë shërbesat fetare aty. Në këtë udhëtim më shoqëroi edhe familja ime. E dinim prej kohësh, që atë ditë do të na shërbente Apostulli i Distriktit Rainer Storck nga bashkësia Essen – Altenessen në Gjermani. U mbledhëm në kishën tonë, e cila ndodhet brenda në kalanë fushore të Elbasanit përballë me Xhaminë Mbret. Ambienti, që të ofron kisha jonë, është e ngrohtë dhe shumë çlodhëse, sepse mbizotëron gjelbërimi dhe pemë të ndryshme frutore. Dhe kjo të jep një ndjesi, që të bën për vete. Ne po prisnim me padurim fillimin e shërbesës, sepse si besimtarë prej vitesh e dimë, që Apostulli i Distriktit apo Apostulli Kryesor në shërbesat e tyre fetare na japin fjalë shumë të veçantë dhe shumë aktuale për ne dhe për situatën, që kalojmë. Dhë vërtet fjala e asaj dite ishte shumë speciale dhe shumë e veçantë. Fjala, që ai mori, ishte marrë nga Psalmi 73, rrjeshti 23 – 24 dhe pikërisht:

“Por megjithatë unë jam gjithnjë me ty; ti më ke kapur nga dora e djathtë. Ti do të më udhëheqësh me këshillën tënde dhe do të më çosh pastaj në lavdi.”

Apostulli Storck që në fillim të shërbesës fetare përmendi një fjalë shumë të bukur dhe të goditur për të gjithë ne: Jezu Krishti është bariu i mirë. Ai është bariu, i cili jep edhe jetën për t'i shpëtuar tufën e tij nga egërsirat. Për këtë ai mori shëmbullin e dy llojeve të barinjve: Bariu, i cili paguhet për atë punë dhe bariu, që e bën punën me zemër dhe me shpirt. Për këtë ai merr shëmbull Jezusin. Jeta jonë është e mbushur me momente nga më të ndryshmet dhe nga më të çuditshmet. Dhe ne nuk duhet të kujtojmë, se jemi vetëm, por Perëndia dhe Jezu Krishti janë gjithmonë me ne. Perëndia nuk i braktis asnjëherë fëmijët e vet. Sepse me anë të Perëndisë dhe Jezusit ne ndjehemi dhe kemi një siguri të madhe prej tyre, sepse Perëndia na mban në dorën

e saj të djathtë. Gjithashtu ai mori si shëmbull një çift të rinjsh, të kapur dorë më dorë. Të kapurit e dorës së djathtë për ata që një shenjë, që u tregonte njerëzve të tjerë, që këta të dy ishin bërë për njëri – tjetrin. Dhe që ata do të ecin të bashkuar gjatë gjithë jetës. Por gjithsesi gjatë jetës sonë gjendemi në situata shumë të vështira, ku ne nuk dimë, si të dalim nga kjo situatë, ku nuk dimë, si të zgjidhim një çështje të rëndësishme. Prandaj gjithmonë ne kemi nevojë për këshillat e Perëndisë dhe të Jezu Krishtit. Prandaj duhet t'ia lëmë në dorë Perëndisë, sepse e di ajo, se cila është zgjidhja e duhur për ne dhe problemet tona. Gjithmonë ne duhet të pranojmë, që të udhëhiqemi dhe të drejtohem gjithmonë nga Perëndia dhe Jezu Krishti. Por momenti më prekës dhe më i veçantë ishte dalja në pension e bishop Karl – Erich Makulla. Të gjithë të pranishmit ngelën pak të habitur, sepse kisha jonë ka nevojë akoma për energjinë dhe fuqinë shpirtërore të këtij njeriu. Gjithkush prej nesh, motrave dhe vëllezërve, e ka ndjerë dashurinë dhe mirësinë e këtij njeriu të Zotit. Ai ka ardhur në vendin tonë mbi pesëdhjetë herë. Ka hyrë dhe ka vizituar qindra familje shqiptare, ku u ka shpallur dhe përhapur fjalën e Perëndisë dhe ka folur për planin e Zotit dhe për Jezu Krishtin. Ashtu siç ka thënë Ai: “Unë jam rruga, jeta dhe e vërteta”. Ne si vëllezër administrate kemi kujtime dhe momente të shumta shumë të bukura me bishop Makullën, ku kemi kaluar çaste të paharrueshme, sepse me fjalën e tij ai na jepte forcë dhe zemër në rrugën tonë të panjohur, në detyrën tonë si mbartës bekimesh duke na treguar përvojën dhe eksperiencën e tij të pasur në punën e Zotit, në punën me motrat dhe vëllezërit e besimit, duke u qëndruar atyre pranë në hallet dhe problemet e tyre. Ai gjatë detyrës së tij si evangjelist i distriktit dhe si bishop nuk ka lënë pas dore punën me të rinjtë dhe fëmijët, sepse edhe si profesion ai ka pasur profesionin e mësuesit, të cilën ai e ka kryer me devotshmëri dhe me dashuri duke u përhapur të rinjve dhe të rejave dijet dhe njohuritë dhe u ka shpjeguar rëndësinë e të nxënimit dhe të mësuarit për jetën dhe për të ardhmen. Për ne ai do të mbetet gjithmonë një burim frymëzimi dhe një pikë mbështetjeje për inspirimin dhe për punën tonë me bashkësitë tona në të ardhmen. Këto ishin disa mbresa të mia nga kjo shërbesë fetare frymëzuese.

Elton Demollari

# Dita e të rinjve – një ushqim shpirtëror për ne



Qëllimi i kësaj dite është të tërheqë vëmendjen për një grup të caktuar të vëllezërve edhe motrave tona, ku çdo aktivitet i dedikohet të rinjve të kishës.

Paraprakisht ndërtohet një plan për organizimin e ditës, ku cdo gjë të jetë perfekte, pasi në fund të ditës presim, që rezultati të jetë pozitiv për secilin pjestar. Ky është qëllimi ynë kryesor.

Dita nis herët në mëngjes, ku të rinjtë nga secili rreth nisen drejt destinacionit të përcaktuar, Dajti Paradise. Pasi lutemi, që udhëtimi i gjithësecilit të shkojë më së miri, presim me një mirëseardhje të ngrohtë çdo anëtar, që arrin. Eh, çfarë kënaqësie është të shikosh të rinjtë e kishës sonë të mbledhur së bashku, ulur nën rrezet e diellit me një buzëqeshje në fytyrë teksa bisedojnë në qetësinë e tyre. Presim tek sa vijnë motrat dhe vëllezërit dhe sa më shumë ata shtohen aq më shumë rritet gëzimi dhe shuajmë mallin, që kishim për njëri-tjetrin. Pasi të gjithë jemi mbledhur edhe përshëndetur me njëri-tjetrin, menjëherë pa humbur kohë mbajmë shërbesën për të dëgjuar edhe falenderuar Atin tonë, që bëri të mundur këtë takim. Lidhim duart, mbyllim sytë, edhe lutemi me gjithë zemrën tonë. Fjala u mbajt nga Kryeplaku ynë Andrea dhe vëllai ynë Fabio, ku përshtatën fjalën pikërisht për këtë ditë, që ne jemi mbledhur, për rininë tonë. Pas shërbesës me zemrat e mbushura plot qetësi edhe dashuri vendosëm të bëjmë një bashkëbisedim me temën "Si e shihni unitetin në bashkësi dhe në besim" duke shkëputur nga këtu nja paragraf nga Efesianët 4,1-6. Të rinjtë shkëmbyen dhe shprehën mendime me shumë vlerë dhe me vërtetësi. Ishin mendime dhe ide, që besoj, se do të na ndihmojnë në punën tonë në të ardhmen, që të rinjtë të bashkohen sa më shumë me njëri – tjetrin, të


komunikojnë sa më tepër me njëri – tjetrin, sepse vetëm në këtë mënyrë forcohet dhe fuqizohet uniteti midis nesh në të ardhmen. Dhe ja ku e mbaruam bisedën tonë plot mendime, opinione edhe afrimetet mes nesh. Me një shpirt të ngopur, të ushqyer mirë erdhi koha të drekojmë si një familje e madhe, që jemi. E pra, ja kjo është bashkësia jonë gjithnjë e mbledhur dhe dashamirëse. Sa bukur duken të rinjtë tanë nën rrezet e atij dielli të bekuar dhe të bashkuar me njëri-tjetrin.

Një tjetër ditë e realizuar një qind për qind, një tjetër memorie e bukur dhe një arsye më shumë për t' u mbledhur sërish bashkë.

Xhivjolda Çela  
Bashkësia Lushnje



Foto: NAK Shqipëri



# Pasqyra

- 07.01.2024 Basel (Zvicër)
- 14.01.2024 Hoorn (Hollandë)
- 19.01.2024 Gisenyi (Ruanda)
- 21.01.2024 Kigali (Ruanda)
- 04.02.2024 Lima (Peru)
- 11.02.2024 Mulhouse (Francë)
- 25.02.2024 Hildesheim (Gjermani)
- 03.03.2024 Palma de Mallorca (Spanjë)
- 10.03.2024 Minden (Gjermani)
- 14.03.2024 Canaan (Myanmar)
- 17.03.2024 Chiang Mai (Tailand)
- 29.03.2024 Wil (Zvicër)
- 31.03.2024 Nagold (Gjermani)

New Apostolic Church  
International

